

RELACION

PËR

PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PËR NGRITJEN E PIKAVE TË PËRBASHKËTA TË KALIMIT KUFITAR, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE KRYERJEN E VEPRIMTARIVE TË PËRBASHKËTA TË KONTROLLIT KUFITAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektakti që propozohet për miratim është iniciuar në kuadër të angazhimeve të përbashkëta të të dyja qeverive, me qëllim thjeshtëzimin dhe lehtësimin e procedurave dhe të masave të lidhura me kontrollet kufitare të menaxhimit të qarkullimit ndërkufitar ndërmjet dy vendeve.

Marrëveshja është iniciuar duke marrë parasysh fluksin në rritje të qarkullimit të shtetasve dhe të mallrave ndërmjet dy vendeve tona, vullnetin për të forcuar dhe zhvilluar më tej bashkëpunimin, si dhe synimin për arritjen e objektivave për përmirësimin e infrastrukturës së transportit rajonal dhe evropian.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj nuk është parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve për vitin 2019, por është në koherencë të plotë me përmbushjen e prioritetëve të qeverisë shqiptare për lehtësimin e kalimit kufitar dhe luftën kundër krimit ndërkufitar, goditjes së trafikimit, akteve terroriste në kufi.

Marrëveshja është në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Kufirit dhe planin e saj të veprimit (Strategjia Ndërsektoriale 2014-2020), e miratuar me vendimin nr.119, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, pjesa “Bashkëpunimi ndërkombëtar Policia Kufitare dhe e Migracionit”, Objektivi strategjik: “Hartimi i akteve ligjore dhe nënligjore të përafuara me *acquis* përkatës, lidhjen e marrëveshjeve me aktorët ndërkufitarë dhe ndërkombëtarë për sistemin e sigurisë kufitare”, Nënobjektivi 1.2.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Marrëveshja parashikon që pikat aktuale jo të përbashkëta të kalimit kufitar të ndryshojnë statusin në pika të përbashkëta të kalimit kufitar, ndërsa pikat e kalimit kufitar që mund të hapen në të ardhmen do të rregullohen sipas parashikimeve të kësaj marrëveshjeje. Gjithashtu, kjo marrëveshje nuk ndikon marrëveshjen për pikat e përbashkëta të kalimit kufitar Shishtavec, Borje dhe Orgjost.

Nisur nga fakti se disa prej pikave të kalimit kufitar janë pika të kalimit kufitar për qarkullim lokal, ku nuk parashikohet qarkullim ndërkombëtar i mallrave, por vetëm i shtetasve, është vlerësuar që autoritetet kompetente për zbatimin e saj të parashikohen në protokollin që do të nënshkruhen, pas miratimit të marrëveshjes.

Përparësitë që priten nga nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje janë, si më poshtë vijon:

- Lehtëson qarkullimin e shtetasve dhe të mjeteve gjatë kalimit të kufirit, si në pjesën e regjistrimit dhe në pjesën e kontrollit;
- Kontrolli dhe verifikimi kufitar kryhen të përbashkët dhe për pasojë minimizohet koha e përpunimit të të dhënave të shtetasve dhe mjeteve gjatë kalimit të kufirit;
- Rrit bashkëpunimin për përmbushjen e interesave të përbashkëta të sigurisë;
- Rrit bashkëpunimin midis palëve në menaxhimin e kontrollin e kufirit dhe përmirëson shkëmbimin e shpejtë të informacionit;
- Rrit dhe intensifikon më tej bashkëpunimin policor;
- Fuqizon mbështetjen reciproke në çështjet policore.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj bazohet në nenin 100 të Kushtetutës, si dhe në nenin 10, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Marrëveshja nuk synon përafrim me *acquis* të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projekt marrëveshja përbëhet nga 17 nene.

Në nenin 1 jepen përkufizimet e termave dhe të akronimeve të përdorura në marrëveshje.

Neni 2 përcakton se qëllimi i kësaj marrëveshjeje është thjeshtësimi dhe përsheptimi i verifikimeve kufitare, me qëllim lehtësimin e qarkullimit të shtetasve dhe të mallrave.

Neni 3 përcakton se pikat e përbashkëta të kalimit kufitar vendosen, me mirëkuptim, në territorin e njëres prej palëve.

Në nenin 4 përcaktohet se të gjitha aktet ligjore të palëve kontraktuese në lidhje me kontrollin e kufirit do të zbatohen në zonën e pikës së përbashkët të kalimit kufitar (ZPPKK). Shkelja e këtyre akteve në territorin e ZPPKK-së do të ketë të njëjtat pasoja ligjore sikur këto shkelje të kishin ndodhur në territorin e secilës palë kontraktuese.

Në nenin 5 përcaktohen modalitetet e kontrolleve kufitare në hyrjen dhe daljen e pikave të përbashkëta, të cilat do të kryhen sipas parimit “një ndalesë një kontroll”.

Në nenin 6 përcaktohen modalitetet mbi mbajtjen e dokumentit të identitetit, uniformave dhe të armëve nga punonjësit që do të operojnë në pikat e përbashkëta të kalimit kufitar.

Në nenin 7 parashikohen rastet kur mund të përdoret forca nga punonjësit e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar.

Neni 8 përcakton se nëpunësit e të dyja palëve gëzojnë të njëjtin nivel mbrojtjeje kur kryejnë detyrat e tyre në zonën e pikës së përbashkët të kalimit kufitar. Gjykatat e shtetit fqinj kanë juridiksionin për të vendosur rreth kërkesave për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga punonjësit e këtij shteti, në aspektin e zbatimit të ligjit në ZPPKK. Këto pretendime gjykohen mbi bazën e ligjit të shtetit fqinj në fjalë.

Neni 9 parashikon modalitetet lidhur me detyrimet dhe pretendimet në rastet kur nëpunësit e shtetit fqinj mund të humbasin jetën ose plagosen në shtetin pritës

gjatë kryerjes së shërbimit ose nëse pësojnë dëmtime fizike. Në këto raste këta nëpunës kompensohen në përputhje me ligjin e shtetit fqinj.

Neni 10 “Ambientet zyrtare” parashikon se pala pritëse merr përsipër sigurimin e ambienteve të nevojshme për nëpunësit e palës fqinje, për ushtrimin e funksioneve zyrtare. Mjediset zyrtare të përdorura për kontrollin kufitar nga të dyja palët kontraktuese do të shënohen me shenja zyrtare dhe simbole shtetërore, në përputhje me rregulloret e brendshme.

Neni 11 parashikon modalitetet për mirëmbajtjen e ambienteve të pikave të përbashkëta të kalimit kufitar. Shpenzimet për mirëmbajtjen e mjediseve të përbashkëta të PPKK-së do të ndahen në mënyrë të barabartë mes palëve.

Neni 12 parashikon mënyrën e përdorimit të pajisjeve dhe objekteve për përdorim zyrtar në PPKK.

Neni 13 përcakton se palët do të ngrenë Komitetin e Përbashkët të Ekspertëve (KPE), i cili do të jetë përgjegjës për zbatimin e marrëveshjes si dhe mënyrën e funksionimit të këtij komiteti.

Neni 14 parashikon se në përputhje me këtë marrëveshje dhe duke marrë në konsideratë rekomandimet e KPE-së, palët bien dakord të nënshkruajnë protokollin zbatues të nevojshme ndërmjet institucioneve përkatëse. Protokollet përcaktojnë aspektet e lidhura me funksionimin e PPKK-ve, si edhe vendin e mënyrën në të cilën do të kryhen kontrollet e përbashkëta.

Neni 15 parashikon modalitetet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve lidhur me interpretimin e marrëveshjes.

Neni 16 parashikon se për arsye sigurie kombëtare apo për mbrojtjen e interesit publik, secila prej palëve mund të pezullojë përkohësisht zbatimin e marrëveshjes apo të secilës prej dispozitave të saj në kushte të rrethanave që diktojnë një vendim të tillë në territorin e tyre. Pala tjetër kontraktuese njoftohet menjëherë me shkrim.

Neni 17 përcakton dispozitat përfundimtare.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Duke qenë se disa prej pikave të kalimit kufitar janë, sipas marrëveshjeve ekzistuese, pika të kalimit kufitar për qarkullim lokal, ku nuk parashikohet qarkullim ndërkombëtar i mallrave, por vetëm i shtetasve, autoritetet

kompetente për zbatimin e marrëveshjes do të parashikohen në protokollet që do të nënshkruhen për zbatimin e saj, sipas specifikave të secilës pikë kalimi kufitar.

Gjithsesi, institucionet që do të ngarkohen me zbatimin e këtij projektligji janë Ministria e Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit), Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, si dhe të gjitha institucionet e ngarkuara me përgjegjësi për menaxhimin e integruar të kufirit.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga Ministria e Brendshme dhe është bashkërenduar me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministrinë e Drejtësisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Në marrëveshje nuk janë parashikuar shpenzime konkrete, pasi në këtë fazë të procedurave është e pamundur të planifikohen. Shpenzimet për secilën palë do të përcaktohen në protokolle të veçanta, të cilat do të lidhen ndërmjet palëve, për hapjen e secilës pikë të përbashkët, pas nënshkrimit të marrëveshjes. Pra, nuk mund të bëhet një vlerësim paraprak mbi detyrimet financiare të palës tonë. Sa i takon krijimit të Komitetit të Përbashkët të Ekspertëve sqarojmë se nuk mbart kosto financiare shtesë për buxhetin e shtetit.

Parimisht palët, në territorin e të cilit do të ndërtohet PPKK-ja, do të kenë detyrimin për ngritjen e të gjithë infrastrukturës së PPKK-së (mjediset e punës, instalimet e nevojshme etj.), por shpenzimet konkrete do të parashikohen në protokollet përkatëse.

KËSHILLI I MINISTRAVE